

Kijani frikën një sprove që nuk godet vetëm keqbërësit

Tefsir el-Kurtubi 7/350-352

Allahu thotë në suren el-Enfal:

“Kijani frikën një sprove që s’do të godasë vetëm ata prej jush që bëjnë keq. Dhe ta dini se Allahu ndëshkon ashpër.” (el-Enfal, 25)

Lidhur me këtë, Imam Ebu Abdullah Muhamed el-Kurtubi përmend pikat në vijim:

Ibn Abas tha:

“Allahu urdhëroi besimtarët të mos pranojnë përhapjen e ligësive mes tyre, pasi atëherë Ai do t’i përfshinte të gjithë me ndëshkim.”

Ez-Zunejr ibn el-Awwaam interpretoi këtë ajet në një mënyrë të njëjtë. Në ditën e betejës së Xhemalit, që ndodhi në vitin 36 pas hixhretit, ai tha:

“Kurrë s’e kam ditur se edhe unë jam përfshirë në këtë ajet. Kam menduar se kjo i referohet vetëm atyre që u drejtohej në fillim të Shpalljes (D.m.th. betejës së Bedrit).”

El-Hasan el-Basri, es-Suddi dhe të tjerët po ashtu e interpretuan kësisoj. Es-Suddi tha:

“Ky ajet u shpall veçanërisht për pjesëmarrësit e betejës së Bedrit, pastaj ata u provuan me belanë e ditës së Xhemalit duke luftuar njëri-tjetrin.”

Ibn Abas tha:

“Ky ajet u shpall për sahabët e pejgamberit ﷺ”, dhe tha po ashtu: “Allahu urdhëroi besimtarët të mos pranojnë përhapjen e ligësisë mes tyre, pasi atëherë Ai do t’i përfshinte të gjithë me ndëshkim.”

Hudhejfe ibn el-Jeman përcolli se i Dërguari ﷺ kishte thënë:

“Një sprovë do të ndodhë mes disa prej sahabëve të mi dhe Allahu do t’i falë për këtë, për shkakun se janë sahabë të mi. Pas tyre, persona të tjerë do të ndjekin shembullin e tyre (në konflikt) dhe Allahu do t’i fusë në xhehenem për këtë.”

Unë (Imam Kurtubi) them: Këto shpjegime mbështeten nga një sërë hadithesh të verifikuara. Në *Sahih Muslim* ka një transmetim nga Zejneb bin Xhahsh, ku tregohet se ajo pyeti të Dërguarin e Allahut ﷺ: “A do të

shkatërrohem ndërsa mes nesh ka njerëz të mirë?”, në çka i Dërguari u përgjigj: “Po, nëse e keqja mbizotëron.”

Në një transmetim në *Sahih et-Tirmidhi*, thuhet:

“Kur njerëzit shohin keqbërësin dhe nuk e ndalin, Allahu, pa vonuar shumë, do t'i përfshijë që të gjithë me ndëshkim.” Dhe ne përmendëm këtë hadith më lart.

Në *Sahih el-Buhari* dhe në *et-Tirmidhi*, ka një transmetim nga en-Nu'man ibn Beshir, ku pejgamberi ﷺ thotë:

“Shembulli i një njeriu që respekton kufijtë e vënë nga Allahu dhe një njeriu që shkel ato është sikurse shembulli i njerëzve që hipin në një anije pasi të hedhin short. Disa prej tyre gjenden nën kuvertë, disa në kuvertë (pjesa e sipërme e anijes). Ata nën kuvertë, sa herë që u duhet uji, e kërkojnë nga ata mbi kuvertë, prandaj propozojnë: ‘Sikur ta hapnim një vrimë në dyshemenë e anijes, nuk do t'ju bezdisnim (me kërkesat për ujë)’. Nëse ata sipër kuvertës do t'i lenin ta zbatonin idenë e tyre, të gjithë do të fundoseshin; nëse nuk i lejojnë, të gjithë do të mbeten të sigurt.”

Ky hadith na mëson se shumë njerëz mund të ndëshkohen për shkak të gjynaheve të një grupi të veçantë.

Ky hadith po ashtu tregon se ndëshkimi mund të ndodhë, për shkak të lënies së urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja. Dijetarët tanë kanë thënë: “Kur çrregullimi (fitneja) përhapet, të gjithë shkatërrohen.” Kjo atëherë kur aktet e mosbindjes bëhen haptazi, keqbërja mbizotëron, dhe nuk ka kurrfarë përpjekje për të përmirësuar. Kur një gjendje e këtillë të zgjasë, atëherë për besimtarët që urrejnë me zemër të keqen bëhet obligim ta braktisin atë vend (nëse ka mundësi). Ky, po ashtu, ka qenë vendimi edhe për popujt para nesh, siç gjejmë në rrëfenjën e Sabathit, ku u lanë gjynahqarët duke u thënë: “Ne s'mund të jetojmë me ju.”

Këtë të kuptuar e gjejmë edhe te selefët. Ibn Wehb përcolli se Maalik tha: “Lër vendin ku gjynahet bëhen haptazi dhe mos bano aty.” Ai mbështeti këtë me veprimin e Ebu Derdasë ؓ, i cili migroi nga toka e Mu'awijes atëherë kur kamata nisi të përdorej haptazi, duke qenë se u lejua që një vazo ari të shitej për më shumë se pesha që kishte. Imam Malik e shënoi këtë në koleksionin e tij të Hadithit.

El-Buhari shënoi transmetimin nga Ibn Umeri ؓ se pejgamberi ﷺ tha:

“Kur Allahu zbret ndëshkimin mbi një popull, i godet të gjithë ata prej tyre që janë të pranishëm, pastaj i ringjallë sipas punëve që kanë bërë.”

Kjo tregon se shkatërrimi që godet të gjithë njerëzit, shërben si pastrim për besimtarët dhe si ndëshkim për kriminelët.

Muslimi shënoi një transmetim nga Abdullah ibnu-Zubejr se Aisha ؓ tregoi se pejgamberi ﷺ kishte bërë lëvizje ndërsa po flinte, pastaj ajo e kishte pyetur: ‘O i Dërguar i Allahut, bëre diçka në gjumë që s’ke bërë asnjëherë më parë.’ Ai u përgjigj: “Është e çuditshme që disa njerëz nga umeti im do ta sulmojnë Qabenë në kërkim të një burri nga kurejshët, i cili do të kërkojë shpëtim aty. Pastaj, kur ata (sulmuesit) të arrijnë te një fushë e gjerë, do t’i përpijë toka.” Thamë: “O i Dërguar i Allahut, a nuk do të ketë edhe njerëz të tjerë aty?!” Ai u përgjigj: “Po, do të ketë asi që do të vijnë me vullnetin e tyre, të tjerë që do të vijnë kundra vullnetit të tyre (me zor), dhe të tjerë që do të gjenden aty pa e ditur. Të gjithë këta do të shkatërrohen dhe Allahu do t’i nxjerrë nga toka sipas qëllimeve që kanë pasur.”

Çka nëse dikush argumenton se Allahu ﷻ thotë:

“Allahu nuk ngarkon ndonjë me barrën (gjynahun) e tjetërkujt.” (6: 164; 17:15; 39:7)

“Çdo shpirt do të merret në përgjegjësi për atë çfarë ka bërë.” (74:38)

“Njeriu do të marrë shpërblimin për të mirën që ka bërë dhe do të bartë pasojat e së keqes që ka bërë.” (2:286)

Këto tekste nënkuptojnë se askush nuk do të ndëshkohet për gjynahet e dikujt tjetër; ndëshkimi ka të bëjë vetëm me atë që bën gjynahun.

Përgjigja në këtë është se, nëse gjynahu përhapet dhe bëhet mbizotërues, atëherë për secilin që e sheh bëhet obligim të mundohet ta ndryshojë gjendjen. Nëse ata mbesin të heshtur karshi gjynahut, të gjithë do të jenë gjynahqarë; njëri është gjynahqar ngaqë bën gjynahun, tjetri është gjynahqar ngaqë nuk bezdiset nga ai gjynah. Kështu, Allahu ﷻ, nga urtësia që e ka, vendosi që ta vendosë në të njëjtin nivel atë që nuk bezdiset nga një gjynah me atë që realisht bën atë gjynah, kështu që të dytë marrin ndëshkimin. Kjo qe shpjeguar nga Ibn el-Arabi dhe po ashtu na vjen në një numër hadithesh që tashmë kemi përmendur.

Porosia kryesore e këtij ajeti është: Kijani frikën një sprove që del nga keqbërësi dhe ndikon njësoj si te i miri, si te i keqi.